

KONTRATE DHURIM KUOTASH ME KUSHT

Ne Tirane, sot me date 12.01.2023 (dymije e njezete e tre) palet, nenshkruajne kete kontrate dhurimi, si meposhte:

DHURUESI:

Sokol Qeraxhiu, atësia Mehmet, i datëlindjes 16.05.1971, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi për të vepruar, identifikuar me leternjoftim ID me nr.personal.H10516142M

PRANUESI I DHURIMIT:

Xheni Kobuzi, atësia Anastas, e datëlindjes 09.09.1986, lindur në Tirane dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi për të vepruar, identifikuar me leternjoftim ID me nr.personal.I65909048E, e cila eshte punonjes prane shoqerise “Tetra PRO” **shpk**, regjistruar si person juridik, me NIPT M22121029F, me seli ne Tirane ne adresen Kompleksi KIKA 2, Rruga “Tish Daija”, kati i dytë, godina Nr.7, njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë.

Dhuruesi **Sokol Qeraxhiu**, eshte zoterues i 93% te kapitalit te **Shoqerise “TETRA PRO” shpk**, regjistruar me NIPT M22121029F, me seli ne Tirane ne adresen Kompleksi KIKA 2, Rruga “Tish Daija”, kati i dytë, godina Nr.7, njësia Bashkiake Nr.5.

Sipas dokumentacionit te depozituar prane QKB-se dhe ndryshimeve te pasqyruara ne skeden e shoqerise kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke i zoteruar nga Sokol Qeraxhiu 93% (93,000 leke), Bruno Sholla 7% (7,000 leke)

Objekti i kontrates

Dhuruesi Sokol Qeraxhiu ne kete kontrate transferon tek **pranuesi ne total 3 %**, te kapitalit te zoteruar prej tij ne **Shoqerine “Tetra PRO” shpk**, me vullnet te lire, te plote dhe te sinqerte, ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe Statutit te Shoqerise.

Me specifikisht ortaku Sokol Qeraxhiu i dhuron :

- Znj. Xheni Kobuzi 3% te aksioneve te zoteruara prej tij ne shoqerine “Tetra PRO” shpk

Ky akt dhurimi, kryhet me kusht qe:

- Znj. Xheni KOBUZI bie dakord te vazhdoje marredheniet e punesimit prane Tetra PRO per nje periudhe 2 vjecare nga nenshkrimi i kontrates dhe ne rast nderprerjes te marredhenieve te punes, ajo humbet zoterimin e aksioneve si me siper, te cilat i kthehen serisht Dhuruesit.

Garancite

Dhuruesi deklaron dhe garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotave qe po transferohen nepermjet kesaj kontrate dhe ato jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjetër ligjor.

Heqje dore nga te drejtat

Dhuruesi deklaron nen pergjegjesine e tij personale se heq dore nga te gjitha te drejtat qe i takojne ne cilesine e ortakut te shoqerise per 3 % te kuotave dhe te gjithë te drejtat dhe detyrimet i kalojne pranuesit te dhurimit per kete perqindje, me nenshkrimin e kesaj kontrate.

Te ndryshme

Pas realizimit te ketij transferimi me nenshkrimin e kesaj kontrate shoqeria “Tetra PRO” shpk do te zoterohet nga ortakët me pjeset si me poshte:

- Sokol Qeraxhiu, me 90 % te kapitalit te shoqerise me vleren 90.000 leke (1 pjese).
- Bruno Sholla, me 7 % te kapitalit te shoqerise me vleren 7.000 leke (1 pjese).
- Xheni Kobuzi, me 3 % te kapitalit te shoqerise me vleren 3.000 leke (1 pjese).

Kjo kontrate u hartua ne 3 ekzemplare me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe.

DHURUESI

Sokol QERAXHIU

PRANUESI I DHURIMIT

Xheni KOBUZI